

20251483301

Në bazë të nenit 62 paragrafit (5) të Ligjit për Mësimdhënësit dhe Bashkëpunëtorët Profesionalë në Shkollat Filllore dhe të Mesme ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 161/19), ministrja e Arsimit dhe Shkencës solli

RREGULLORE PËR MËNYRËN E FORMIMIT TË KOMISIONIT, VLERËSIMIN E APLIKIMEVE DHE DOKUMENTACIONIT TË PRANUAR TË BASHKËPUNËTORËVE PROFESIONALË PËR FITIMIN E TITULLIT BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL-MENTOR DHE BASHKËPUNËTOR PROFESIONAL-KËSHILLTAR, PIKËZIMIN E KANDIDATËVE, LISTËN E RENDITJES, SI DHE MËNYRËN E PUNËS SË KOMISIONIT

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra e formimit të komisionit, vlerësimi i aplikimeve dhe dokumentacionit të pranuar nga bashkëpunëtorët profesionalë për fitimin e titullit bashkëpunëtor profesional-mentor dhe bashkëpunëtor profesional-këshilltar, pikëzimin e kandidatëve, listën e renditjes, si dhe mënyrën e punës së komisionit.

Neni 2

Komisioni për verifikimin e përmbushjes së standardeve profesionale për titujt bashkëpunëtor profesional-mentor dhe bashkëpunëtor profesional-këshilltar (në tekstin e mëtejshme: komisioni) formohet jo më vonë se 15 ditë pune nga dita e përfundimit të publikimit të thirrjes publike për përfitimin e titullit bashkëpunëtor profesional-mentor dhe bashkëpunëtor profesional-këshilltar (në tekstin e mëtejshme: thirrja publike), e cila publikohet në ueb-faqen e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (në tekstin e mëtejshme: Ministria) e cila publikohet në gjysmën e dytë të vitit vijues dhe zgjat nga një deri në dy muaj, pas dorëzimit të propozimeve paraprake për anëtarë nga fakultetet përkatëse, nga sindikata përfaqësuese për arsim, nga Bashkësia e Njësive të Vetëqeverisjes Lokale, nga Ministria dhe Byroja për Zhvillimin e Arsimit (në tekstin e mëtejshme: Byroja).

Neni 3

Komisioni, për kandidatët e paraqitur në thirrjen publike, kryen vlerësimin e përmbushjes së kushteve për fitimin e titullit bashkëpunëtor profesional-mentor ose bashkëpunëtor profesional-këshilltar, përmes kontrollit të formularit me dokumentacionin dhe dëshmitë e bashkangjitura në aplikacionin elektronik në ueb-faqen e Ministrisë.

Neni 4

Kandidati i cili nuk i plotëson kushtet për avancim në titullin bashkëpunëtor profesional-mentor ose bashkëpunëtor profesional-këshilltar, njoftohet se nuk merrë pjesë në procedurën e mëtejshme. Nëse kandidati nuk ka bashkangjitur dokumentet dhe dëshmitë e plota në aplikacionin elektronik në ueb-faqen e Ministrisë dhe pas kërkesës duhet t'a komplotojë dokumentacionin të njejtin nuk e ka bërë, nuk ka marrë pjesë në procedurën e mëtejshme. Kandidatët nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni njoftohen përmes aplikacionit elektronik në ueb-faqen e Ministrisë.

Neni 5

Nga ana e komisionit, më së voni 50 ditë nga dita e ndarjes së fjalëkalimit për mbikëqyrje në futjen e dokumenteve në aplikacionin elektronik, paraqitet kërkesë deri te Byroja për dorëzimin e vlerësimit për përmbushjen e standardeve për bashkëpunëtor profesional-mentor ose bashkëpunëtor profesional-këshilltar, si dhe kërkesë deri te shkolla ku punon kandidati për

dorëzimin e mendimit për përmbushjen e standardeve për bashkëpunëtor profesional-mentor ose bashkëpunëtor profesional-këshilltar, përveç kandidatëve nga neni 7, paragrafi 2 të kësaj rregullore. Nga ana e Byrosë, më së voni 30 ditë nga dita e pranimi të kërkesës nga paragrafi 1 i këtij neni, deri te komisioni është dorëzuar vlerësim për përmbushjen e standardeve nga paragrafi 1 i këtij neni, për çdo kandidat. Nga ana e shkollës ku punon kandidati, më së voni 15 ditë nga dita e pranimi të kërkesës nga paragrafi 1 i këtij neni, deri te komisioni dorëzohet mendim për përmbushjen e standardeve nga paragrafi 1 i këtij neni, për çdo kandidat. Shkolla jep mendimin në bazë të të dhënave me të cilat disponon ekipi për zhvillim profesional në shkollë, mendimin e mësimdhënësve, mendimin e prindërve dhe mendimin e nxënësve.

Nga Byroja, vlerësimi për përmbushjen e standardeve profesionale për bashkëpunëtor profesional-mentor apo bashkëpunëtor profesional-këshilltar, gjegjësisht nga shkolla, mendimi për përmbushjen e standardeve për bashkëpunëtor profesional-mentor apo bashkëpunëtor profesional-këshilltar, bashkangjiten në aplikacionin elektronik në ueb-faqen e Ministrisë.

Neni 6

Nga komisioni bëhet pikëzimi në bazë të dëshmive nga aplikacioni elektronik në ueb-faqen e Ministrisë, vlerësimi për përmbushjen e standardeve për bashkëpunëtor profesional-mentor ose bashkëpunëtor profesional-këshilltar nga Byroja dhe mendimi nga shkolla për përmbushjen e standardeve për bashkëpunëtor profesional-mentor ose bashkëpunëtor profesional-këshilltar.

Neni 7

Pikëzimi i kandidatëve bëhet sipas Listës së pikëve për trajnimet, konferencat shkencore-profesionale, kongreset, simpoziumet, autorësinë, pjesëmarrjen në aktivitete për përmirësimin e punës edukativo-arsimore dhe shpërblimet dhe mirënjohjet (në tekstin e mëtejme: Lista e pikëve), e cila është vënë në Shtojcën nr. 1 dhe është pjesë përbërëse e kësaj rregullore. Për kandidatët të cilët kanë fituar më pak se 45 pikë për titullin bashkëpunëtor profesional-mentor, përkatësisht më pak se 60 pikë për titullin bashkëpunëtor profesional-këshilltar, sipas Listës së pikëve, komisioni nuk dorëzon kërkesë deri te Byroja për dhënien e vlerësimi për përmbushjen e standardeve profesionale dhe deri te shkolla për dhënien e mendimit për përmbushjen e standardeve profesionale të bashkëpunëtorit profesional nga shkolla fillore gjegjësisht shkollat e mesme. Kandidatët nga paragrafi 2 i këtij neni, ju njoftojnë për pikët e tyre përmes mbikëqyrjes në aplikacionin elektronik në ueb-faqen e Ministrisë.

Neni 8

Komisioni, për secilin kandidat, mbledh pikët nga vlerësimi i Byrosë për përmbushjen e standardeve profesionale për bashkëpunëtor profesional-mentor, gjegjësisht bashkëpunëtor profesional-këshilltar, mendimi nga shkolla për përmbushjen e standardeve profesionale për bashkëpunëtor profesional-mentor, gjegjësisht bashkëpunëtor profesional-këshilltar, dhe pikët nga Lista e Pikëve.

Neni 9

Numri më i lartë i mundshëm i pikëve nga Lista e Pikëve është 80 për titullin bashkëpunëtor profesional-mentor, gjegjësisht 100 për titullin bashkëpunëtor profesional-këshilltar. Numri më i lartë i mundshëm i pikëve nga vlerësimi për përmbushjen e standardeve profesionale është 80 për titullin bashkëpunëtor profesional-mentor, gjegjësisht 100 për titullin bashkëpunëtor profesional-këshilltar. Numri më i madh i mundshëm i pikëve nga mendimi për përmbushjen e standardeve profesionale të bashkëpunëtorit profesional nga shkolla fillore gjegjësisht të mesme është 20 për titullin bashkëpunëtor profesional-mentor, gjegjësisht 25 për titullin bashkëpunëtor profesional-këshilltar.

Numri më i madh i përgjithshëm i pikëve të mundshme nga Lista e Pikëve, nga vlerësimi për përmbushjen e standardeve profesionale dhe nga mendimi për përmbushjen e standardeve profesionale të bashkëpunëtorit profesional nga shkolla fillore, gjegjësisht shkollat e mesme për titullin bashkëpunëtor profesional-mentor është 180, gjegjësisht për titullin bashkëpunëtor profesional-këshilltar 225.

Neni 10

Pas kryerjes së pikëve të kandidatëve për bashkëpunëtor profesional-mentor, nga komisioni përgatitet listë të kandidatëve për komunën, komunën e Qytetit të Shkupit, gjegjësisht për Qytetin e Shkupit, të cilët, në përputhje me vlerësimin nga neni 7 i kësaj Rregullore, kanë fituar: nga zhvillimi profesional së paku 45 pikë, nga vlerësimi për përmbushjen e standardeve profesionale nga Byroja të paktën 45 pikë dhe nga mendimi i shkollës së paku 11 pikë.

Pas kryerjes së pikëve të kandidatëve për bashkëpunëtor profesional-këshilltar, nga Komisioni përgatitet listë të kandidatëve sipas komunave, komunës së Qytetit të Shkupit, gjegjësisht për Qytetin e Shkupit, të cilët, në përputhje me pikëzimin nga neni 7 i kësaj Rregullore, kanë fituar: nga zhvillimi profesional i bashkëpunëtorëve profesional së paku 60 pikë, nga vlerësimi për përmbushjen e standardeve profesionale nga Byroja së paku 60 pikë dhe nga mendimi i shkollës të paktën 15 pikë.

Për kandidatët të cilët janë në listat nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, dhe sipas numrit të bashkëpunëtorëve profesionalë që mund të fitojnë titullin bashkëpunëtor profesional-mentor ose bashkëpunëtor profesional-këshilltar të përcaktuar në përputhje me nenin 59 paragrafin (4) të Ligjit për Mësimdhënësit dhe Bashkëpunëtorët Profesionalë në Shkollat Fillore dhe të Mesme, kryhet kontroll i dokumenteve dhe dëshmimeve për zhvillimin profesional, të cilat kandidatë duhet t'i dorëzojnë komisionit në origjinal ose në kopje të vërtetuar në noter, jo më vonë se 10 ditë nga dita e përgatitjes së listës nga paragrafi 1, përkatësisht paragrafi 2 i këtij neni.

Pas kontrollit të kryer nga paragrafi 3 i këtij neni, përgatitet Listë renditjeje sipas komunës, komunës në Qytetin e Shkupit, përkatësisht për Qytetin e Shkupit.

Formulari për Listën e Renditjes nga paragrafi 4 i këtij neni, për bashkëpunëtor profesional-mentor është dhënë në Shtojcën nr. 2, ndërsa për bashkëpunëtor profesional është dhënë në Shtojcën nr. 3, të cilat janë pjesë përbërëse e kësaj rregullore.

Neni 11

Lista e renditjes nga neni 10 paragrafi 4 i kësaj Rregullore, nga komisioni dorëzohet në Ministri.

Neni 12

Çdo anëtar i Komisionit i ndahet fjalëkalim me të cilin i njëjti mund të ketë mbëkëqyrje në dokumentet e futura në aplikacionin elektronik në ueb-faqen e Ministrisë.

Neni 13

Komisioni në seancën e parë nga radhët e anëtarëve përzgjedh kryetar.

Neni 14

Për çdo seancë të mbajtur të Komisionit mbahet procesverbal. Procesverbali përmbanë të dhëna për: kohën dhe vendin e seancës, rendin e ditës, anëtarët pjesëmarrës dhe jo pjesëmarrës të Komisionit, pasqyrën e kandidatëve të cilët janë pikëzuar me numrin e pikëve. Procesverbali nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm në seancë.

Neni 15

Në ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, pushon së vlefshmi Rregullorja për mënyrën e formimit të komisionit, vlerësimin e aplikimeve dhe dokumentacionit të pranuar të bashkëpunëtorëve profesionalë për fitimin e titullit bashkëpunëtor profesional-mentor dhe bashkëpunëtor profesional-këshilltar, pikëzimin e kandidatëve, listën e renditjes, si dhe mënyrën e funksionimit të komisionit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 187/20).

Neni 16

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme nga dita publikimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".

Nr. 13-10335/1
21.7.2025
Shkup

Ministre e Arsimit
dhe Shkencës,
Pr.Dr. **Весна Јаневска**, d.v.

Shtojcë nr.1

Listë e pikëve për trajnime, konferenca shkencore-profesionale, kongrese, simpoziume, autorësi, pjesëmarrje në aktivitete për përmirësimin e punës edukativo-arsimore dhe çmime e mirënjohje

	Lloji i programeve të trajnimit	Roli i kandidatit në trajnim (mënyra e fitimit të certifikatës)	Pikë për trajnime sipas orëve të kaluara				
			3-6 (orë)	7-18 (orë)	19-30 (orë)	mbi 30 (orë)	
1.1	• Programet e akredituara të trajnimit nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit • Trajnim të realizuara nga Byroja për Zhvillimin e Arsimit, Qendra për Zhvillimin e Arsimit Profesional dhe Qendra Shtetërore e Provimeve • Trajnim të mbështetura nga organizatorë në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, Byronë për Zhvillimin e Arsimit, Qendrën për Zhvillimin e Arsimit Profesional dhe Qendrën Shtetërore të Provimeve	• Trajner për modul trajnimi në nivel kombëtar dhe trajner i trajnerëve	3	6			
1.2		• Diseminues i trajnimeve kombëtare në nivel lokal dhe shkollor	2	4			
1.3		• Kandidat që posedon dëshmi (certifikata, konfirmim ose të ngjashme) për zbatimin e njohurive të fituara, të vërtetuar përmes procedurës së përcaktuar të certifikimit	4				
1.4		• Pjesëmarrje në trajnim në nivel kombëtar	1	1,5	2	2,5	
1.5		• Pjesëmarrje në diseminim të trajnimit	0,5	1	1,5	2	
1.6	Programet jo të akredituara për trajnime (p.sh. të organizuara nga institucione të arsimit të lartë, vetëqeverisje lokale, shkolla, trajnime të brendshme, forma individuale të trajnimeve (brenda ose jashtë vendit), webinarë, trajnime online, projekte)	• Trajnes/ndihmës/fasilitator për modul	0,5	1	1,5	2	
1.7		• Pjesëmarrje në trajnim	0,2	0,4	0,6	0,8	
	Ngjarje	Roli	Numri i pikëve për ngjarje individuale				
2.1	Konferenca shkencore / Konferenca profesionale / Kongrese / Simpoziume / qëndrime profesionale	Prezantim plenar	4				
2.2		• Punim i recenzuar pozitivisht dhe i botuar në materialet e ngjarjes	3				
2.3		• Anëtar i bordit organizativ	2				
2.4		• Prezantim poster / referat / moderator sesioni / moderues	1,5				

2.5	• Pjesëmarrës dëgjues • Qëndrim studimor në shtet të huaj – mbi 7 ditë	1
2.6		2,5
Aktivitet		
3.1	Autor/bashkautor i tekstit shkollor të miratuar dhe manual të miratuar (për nxënës ode mësimdhënës)	Број на бодови за поединечна активност 4
3.2	Punim i publikuar në revistë profesionale të indeksuar ose revistë me faktor ndikimi	4
3.3	Punim i botuar në revistë profesionale	2
3.4	Materiale mësimore profesionale të miratuara nga shkolla (skripte, manuale, mjete ndihmëse , etj.) të përdorura brenda shkollës sipas lëndës	2
3.5	Recensues i literaturës/tekstit shkollor/manualit profesional	2
3.6	Përkthim/redaktim profesional i literaturës profesionale të publikuar	1
3.7	Autor i moduli ose manuali për trajnim në nivel kombëtar	2
Aktivitet		
4.1	Pjesëmarrje në krijimin e dokumenteve konceptuale, programe dhe sistematike	Pikat për provat individuale 3
4.2	Pjesëmarrës në përgatitjen e instrumenteve për vlerësimin e arritjeve	1
4.3	Anëtar i ekipit kërkimor për projekte shkencore-kerkimore në nivel shtetëror nga institucionet shkencore-profesionale në vend	3
4.4	Pjesëmarrje në zbatimin e projekteve inovative në shkollë dhe ndërmjet shkollave	2
Thirrja/tituli shkencor		
5.1	Doktor i shkencave	Pikë
5.2		4
5.3		2
5.4		

Lloji i çmimit		
Numri i pikëve		
6.1	Çmim për punë profesionale dhe arritje të jashtëzakonshme të bashkëpunëtorit profesional të	nivel ndërkombëtar
6.2		nivel shtetëror
6.3		nivel komunal
6.4	Çmim për punë profesionale dhe arritje të jashtëzakonshme të bashkëpunëtorit profesional të	nivel ndërkombëtar
6.5		nivel shtetëror

Shtojcë nr.2

Lista e renditjes së kandidatëve për titullin bashkëpunëtor profesional–mentor sipas komunave dhe Qytetit të Shkupit

Nr. rendor	Komuna (sipas rendit alfabetik) dhe Qyteti i Shkupit	Shkolla	Emri dhe mbiemri i kandidatit	Pikët nga vlerësimi i Byrosë për Zhvillimin e Arsimit / Qendrës për Zhvillimin e Arsimit Profesional	Pikët nga zhvillimi profesional	Pikët nga mendimi i shkollës	Pikët totale

Data: _____

Komisioni:

Kryetar _____
Anëtar _____
Anëtar _____
Anëtar _____
Anëtar _____

Shitojë nr.3

Lista e renditjes së kandidatëve për titullin bashkëpunëtor profesional–këshilltar sipas komunave dhe Qytetit të Shkupit

Nr. rendor	Komuna (sipas rendit alfabetik) dhe Qyteti i Shkupit	Shkolla	Emri dhe mbiemri i kandidatit	Pikët nga vlerësimi i Byrosë për Zhvillimin e Arsimit / Qendrës për Zhvillimin e Arsimit Profesional	Pikët nga zhvillimi pr ofesional	Pikët bazuar në vlerësimin e shkollës	Pikët totale

Data: _____

Komisioni

Kryetar _____
Anëtar _____
Anëtar _____
Anëtar _____
Anëtar _____